



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument Parlamentar

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 27.06.2023

RAPORT PËR SHQYRTIMIN E RAPORTIT VJETOR TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM MBI GJËNDJEN E KRIMINALITETIT PËR VITIN 2022, DHE MIRATIMIN E PROJEKTREZOLUTËS PËR VLERËSIMIN E ORGANIT TË PROKURORISË PËR VITIN 2023

Komisioni për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbledhjen e datës 17 Maj 2023, në zbatim të nenit 148/b shkronja (d), të Kushtetutës, nenit 38, pika 2, shkronja (d), e ligjit nr.97/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe neneve 18, dhe 103 të Rregullores së Kuvendit, mori në shqyrtim “Raportin e Prokurorit të Përgjithshëm për Gjendjen e Kriminalitetit për Vitin 2022”.

Raporti vjetor, pasqyron të dhëna të detajuara, për numrin, llojet, shtrirjen territoriale, intensitetin, viktimat, kostot e kriminalitetit, format e kriminalitetit në vend, efektivitetin e ndjekjes penale, cilësinë e përfaqësimit të akuzës në gjyq, ekzekutimin e vendimeve penale dhe veprimtari të tjera thelbësore në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, përgjatë vitit 2022.

Përmbledhja e Raportit të Prokurorisë së Përgjithshme për Gjendjen e Kriminalitetit për vitin 2022, u prezantua nga Prokurori i Përgjithshëm z. Olsian Çela.

Pas prezantimit të raportit vjetor nga Prokurori i Përgjithshëm, diskutimeve dhe pyetjeve të deputetëve, u konstatuan disa arritje dhe problematika të këtij institucioni, për të cilat u sugjerua që të reflektohen në projekt-rezolutën që do miratohej nga Komisioni për vlerësimin e veprimtarisë së organit të prokurorisë për vitin 2022.

Në mbledhjen e datës 27 Qershor 2022, në Komision u diskutua dhe për projekt-rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2022”. Komisioni me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, miratoi projekt-rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2022”, sipas propozimit të relatorit, duke pasqyruar në versionin final edhe sugjerimet konsultuar me institucionin me qëllim paraqitjen për votim seancës plenare të Kuvendit të Shqipërisë.

Bashkëlidhur teksti integral i Projekt-Rezolutës.

RELATOR

Toni GOGU

KRYETARE

Klotilda BUSHKA